

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.99/2018 “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

A. MËNYRA E NDËRHYRJES

Ky Akt Normativ propozohet në mbështetje të nenit 101, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Projektakti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimet nr.24, datë 10.11.2006, nr.23, datë 16.4.2014, etj. Konkretisht, për miratimin e një Akti Normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijnë¹:

1. *Nevoja dhe urgjenca, si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;*
2. *Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;*
3. *Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;*
4. *Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.*

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;

Neni 101 ka parashikuar ‘**nevojën**’ dhe ‘**urgjencën**’ si rrethana dhe situata fakti, që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2019. Ky rishikim propozohet t’i nënshtrohet procedurës së Aktit Normativ, aspekti i nevojës dhe emergjencës së të cilit lidhet me këto arsye kryesore:

- *Kompensimin e zërave të shpenzimeve buxhetore, që u prekën në fillimvitin 2019, për efekt të financimit të Paktit për Universitetin;*
- *Reflektimin e ecurisë optimale të të ardhurave vendore gjatë gjysmës së parë të vitit 2019.*
- *Garantimin e financimit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit, në vijim të situatës emergjente të krijuar pas tërmetit të datës 21.9.2019;*
- *Rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve publike për rishpërndarje drejt projekteve të investimeve me progres të mirë deri tani;*
- *Rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit në tërësi;*

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 24, datë 10.11.2006,

Njëkohësisht, **nevoja dhe urgjenca** konsiston edhe në faktin se synon:

- a) *të ruajë nivelin e planifikuar, në buxhetin e vitit 2019, të parametrave kryesorë makroekonomikë, të tillë si: nivelin e deficitit buxhetor (rrjedhimisht dhe nivelin e borxhit publik), ndërkohë që niveli i sufiçitit primar vazhdon të ruhet në terma pozitivë nominalë dhe kundrejt PBB-së;*
- b) *të reflektojë rritjen e tavanit të shpenzimeve për njësitë vendore, në masën 4 miliardë lekë, si rrjedhojë e rritjes në masën 3 miliardë lekë të të ardhurave vendore, dhe, në masën 1 miliardë lekë të financimit të huaj vendor. Ky i fundi, kompensuar me pakësimin në të njëjtën masë të financimit të huaj qendror;*
- c) *të mundësojë shlyerjen në kohë të detyrimeve financiare kontraktuale të institucioneve buxhetore nëpërmjet rialokimeve buxhetore, duke reduktuar, kështu, mundësinë e krijimit të detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2019;*
- ç) *akomodimin e nevojave të reja të funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë (Vettingu-t), si nga pikëpamja e shpenzimeve ashtu edhe e numrit të punonjësve;*
- d) *sistemime dhe/ose rialokime të tjera pa kosto shtesë efektive ndërmjet zërave të shpenzimeve buxhetore, bazuar në ecurinë faktike 9-mujore, por të cilat ndikojnë ndjeshëm në rritjen e performancës së pritshme të realizimit të treguesve në fund të vitit 2019;*
- dh) *një argument tjetër për ndryshimet e bëra është edhe nevoja që Këshilli i Ministrave, si ushtruesi më i madh i të drejtës së iniciativës ligjvënëse, dhe vetë Kuvendi të veprojnë pa cenuar ekonominë ligjvënëse, që nënkupton se, me rastin e ekzistencës së nevojës dhe urgjencës për disa ndryshime në ligjin e buxhetit, mund të adresohen, njëkohësisht, edhe ndryshime të tjera jo domosdoshmërisht urgjente. Një gjë e tillë është logjike e kursimit legjislativ, duke mos angazhuar Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin në procese legjislative të herëpashërëshme dhe të së njëjtës natyrë.*

Është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e propozuara nuk prekin treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë, duke ruajtur deficitin në nivele të pandryshueshme dhe forcuar më tej objektivin e qeverisë për qëndrueshmëri fiskale.

2. Përkohshmëria

Akti Normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTLIGJI

Bazuar në performancën makrofiskale e buxhetore të 6-mujorit të parë të vitit 2019 si dhe në parashikimin e pritshëm të këtyre treguesve deri në fund të këtij viti buxhetor, Akti Normativ që ju propozojmë konsiston në:

- **ruajtjen e parametrave kryesore të buxhetit të miratuar në fillim të vitit.** Deficiti buxhetor mbetet i pandryshuar, ndërkohë që të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit pësojnë sistemime të vogla mes zërave, efekt ky neutral për buxhetin e shtetit;
- **rishpërndarje brenda zërave të shpenzimeve të buxhetit, të cilat:**
 - a) **sigurojnë financimin për disa zëra sensitivë të shpenzimeve korente**, si fondi rezervë, skema e fermerëve, skema e PAK-ut, arsimit i lartë, rendi, mbrojtja, etj, dhe, konkretisht, disa prej tyre:
 - ✓ *Ministria e Brendshme: 450 mln lekë për orët jashtë orarit për efektivët e Policisë së Shtetit dhe ushqim & orë pune FNSH/kursantët, si edhe 30 mln lekë për pagat e Gjendjes Civile;*
 - ✓ *Ministria e Mbrojtjes: 120 mln lekë për mirëmbajtjen e sistemit ‘Palantir’ dhe 330 mln lekë për misionet jashte vendit;*
 - ✓ *Ministria e Shëndetësisë: 300 mln lekë për skemën e PAK-ut, si kompensim i financimit të Paktit për Universitetin, dakordësuar në janar 2019.*
 - ✓ *Ministria e Arsimit: 300 mln lekë për Arsimin Bazë, si kompensim i financimit të Paktit për Universitetin, dakordësuar në janar 2019;*
 - ✓ *Ministria e Bujqësisë: 200 mln lekë për Skemën e Fermerëve, për kompensimin e çmimit të qumshtit.*
 - b) **Rrisin performancën e shpenzimeve kapitale** nëpërmjet shpërndarjes së burimeve dhe rishpërndarjes së fondeve drejt projekteve të investimeve publike, të cilat rezultojnë me progres të mirë deri tani, me qëllim arritjen e nivelit të programuar të tyre për vitin 2019. Kjo, gjykuar edhe nga trendi ndër vite i realizimit të investimeve publike, ku punimet përqendrohen, kryesisht, në tremujorin e fundit. Konkretisht, ky Akt Normativ garanton ndër të tjera:
 - ✓ **MIE:** 1 miliardë lekë financim i huaj për të mundësuar avancimin e punimeve në By-Pass-in Fier dhe përfundimin e një krahu të rrugës; dhe 370 milionë lekë shpronësimet në objektet e Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 - ✓ **FSHZH:** 800 milionë lekë për avancimin e projekteve kryesore të programeve të zhvillimit.
 - ✓ **Ministria e Kulturës:** 200 milionë lekë për shtimin e ritmit të punimeve për rikonstruksionin dhe pajisjet e godinës së TKOB, për të mundësuar përfundimin e këtij projekti të rëndësishëm brenda afateve të parashikuara.
 - ✓ **Ministria e Bujqësisë:** 200 milionë lekë për vazhdimin e financimit të projekteve me fokus mbrojtjen e argjinaturave lumore, dhe sistemin e kanaleve ujitëse;
 - ✓ **Ministria e Financave:** 125 milionë lekë për blerjen e pajisjeve për “Polin e Drejtësisë”.
 - ✓ **Ministria e Shëndetësisë:** 90 milionë lekë për “Rikonstruksionin e godinës së Maternitetit të Vjetër”.
 - ✓ **Bashkia Tiranë:** 1 miliardë lekë për avancimin e punimeve për projektin e “Bulevardit Verior dhe Rehabilitimit të Lumit të Tiranës”.

Si konkluzion, bazuar në performancën makrofiskale e buxhetore të 6-mujorit 2019, në gjykimin tonë, Akti Normativ që ju propozojmë do t’i japë zgjidhje disa problematikave të hasura gjatë implementimit të deritanishëm të buxhetit të shtetit, duke mundësuar arritjen e objektivave të rëndësishme si:

- (i) *ruajtjen të pandryshuar të nivelit të planifikuar të parametrave kryesorë makroekonomikë;*
- (ii) *garantimin e financimit të nevojave të pushtetit vendor;*
- (iii) *garantimin e financimit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit, për përballimin optimal të situatës emergjente.*
- (iv) *rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve publike nëpërmjet rialokimeve mes zërave të shpenzimeve*
- (v) *rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit.*

KËSHILLI I MINISTRAVE